



4 Martesa në Shqipëri

Qëllimi: Autoritetet shqiptare kërkojnë një certifikatë mbi aftësinë martesore për të lidhur kurorë me një shtetas zviceran (apo një person me nënshtetësi të dyfishtë shqiptaro-zvicerane) në Shqipëri.

Ju lutemi të mos vonoheni në ditën e takimit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni takim të ri.

Të keni parasysh se:

- **Asnjë dokument** nuk duhet të dërgohet drejtpërdrejt në ambasadë.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet **personalisht** në ditën kur ju është caktuar takimi.
- Dosjet e pakompletuara **nuk pranohen**.

► Dokumentet e nevojshme:

Partneri, i cili jeton në Shqipëri duhet t'i dorëzojë këto dokumente në Ambasadën Zvicerane:

- Formulari i plotësuar "Kërkesë për lëshimin e një certifikate mbi aftësinë martesore" (pa datë, pa nënshkrim).
- Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit si dhe 2 kopje.
- 2 kopje të pasaportës të bashkëshortit/-es në Zvicër.
- Certifikata e lindjes origjinale e lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja
- Certifikata familjare origjinale.
- Certifikata personale origjinale. *
- Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër.
- Nëse keni ndryshuar emrin: Kopje e vërtetuar e vendimit të ndryshimit të emrit lëshuar nga gjykata.*
- Nëse jeni i/e shkurorëzuar: Kopje e vërtetuar e vendimit të shkurorëzimit (me shënimin rreth plotfuqishmërisë) lëshuar nga gjykata. *
- Nëse jeni i/e ve: Certifikata e vdekjes i/e bashkëshortit/-es.
- Nëse keni lindur jashtë martesës: Procesverbal për njohje atësie.*
- Nëse keni fëmijë të përbashkët: Certifikata e lindjes e fëmijës.

INFORMACIONE TË RËNDËSISHME:

- **Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.**
- Të gjitha dokumentet të cilat janë vetëm në gjuhë shqipe duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Partneri, i cili jeton në Zvicër duhet të interesohet në Qendrën e Statusit Civil përkatës për hapat e mëtutjeshëm rreth certifikatës mbi aftësinë martesore të Zvicrës.
- Certifikata mbi aftësinë martesore e Zvicrës në të shumtën e rasteve dërgohet nga autoritetet Zvicerane në ambasadë dhe ajo ia dorëzon partnerit shqiptar pas pagesës së tarifës përkatëse.
- Për martesën në Shqipëri ju duhet të informoheni patjetër tek autoritetet e gjendjes civile ku do të martoheni, për t'u njoftuar se cilat dokumente shtesë (përveç certifikatës mbi aftësinë martesore) kërkohen për kurorëzim.
- Për të regjistruar martesën tuaj në Zvicër, pas kurorëzimit duhet të dorëzohet certifikata e martesës origjinale në ambasadë me termin të caktuar paraprakisht.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Formularët dërgohen falas përmes e-mailit nga Ambasada Zvicerane.

Të gjitha dokumentet shqiptare duhet të jenë të pajisur me vulë apostile nga Ministrisa e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.



Qendra Regjionale Konsullore për Ballkanin Perëndimor c/o Ambasada Zvicerane në Kosovë

Informacione të përgjithshme:

- Vetëm personave me takim të caktuar ju lejohet hyrja tek sporteli.
- Vendimet merren vetëm nga autoritetet e kantonit apo të shtetit federal në Zvicër.
- Për informata shitesë: www.eda.admin.ch/westbalkan

Si caktohet takimi:

1. **Caktimi i takimi:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar takim: pristina.visa@eda.admin.ch. Ju lutemi të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të secilit person që dëshiron të bëjë kërkesë për bashkim familjar**.
2. **Dorëzimi i dokumenteve :** Përmbajuni udhëzimeve në lidhje me takimin dhe siguroni të gjitha dokumentet e nevojshme. Ejani në ambasadë në ditën dhe orarin e takimit tuaj.
3. **Marrja e vendimit :** Certifikata mbi aftësinë martesore e Zvicrës në të shumtën e rasteve dërgohet nga Zvicra në **a m b a s a d e** dhe ajo ja dorëzon partnerit shqiptar pas pagesës së tarifës përkatëse.

Takimet caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka takime me prioritet).

Orari i punës i sektorit konsullor:

Dorëzimi i aplikimit:

vetëm me takim

e hënë - e premte

Pagesat për aplikim:

Shpenzimet për procedurën në Prishtinë janë **299 EUR**.

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastiit: **Pagesë shitesë administrative**.
- Paratë e pagesës nuk rimbursohen (edhe në rast se viza refuzohet).

Kuides nga Agjencitë

- Gjithë ata që ofrojnë shërbime jashtë rrethojave të zeza nuk i përkasin stafit të ambasadës.
- Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me asnjë agjenci jashtë ndërtesës së vet.
- Stafit i Ambasadës Zvicerane nuk ka kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.
- Ambasada Zvicerane gjendet në hapësirat e kufizuara me rrethoja të zeza.
- Ambasada Zvicerane i jep formularët pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane jep informata pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane nuk rekomandon asnjë kompani të sigurimeve.

Kini parasysh se Ambasada Zvicerane:

- Nuk pranon aplikim në rast se nuk keni takim të caktuar.
- Nuk jep informata (me telefon apo email) për kërkesat e parashtruara.
- Ka të drejtë:
 - ° të kërkojë dokumente shitesë.
 - ° ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
 - ° ti thërrasë aplikantët në bisedë ose intervistë.
 - ° ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.